

Programi për reforma në sektorin e zbulimit dhe sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2026)

BULETINI N° 4

PRILL - QERSHOR 2022

Programi për reforma në sektorin e zbulimit dhe sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2026) ka vazhduar që të përfitojë rëndësi me të madhe me qëndrueshmërinë e DCAF në realizimin e aktiviteteve dhe angazhimin aktiv të palëve parësore të përfshira. Të gjithë aktivitetet online dhe offline kanë shtuar një përpjekje shtesë në angazhimin e DCAF për të ndërtuar një sektor të zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut që do të ishte demokratik, rezistues, dhe i qeverisur më mirë.

REZULTATI I

Që nga maji i vitit 2022, DCAF ka ofruar mbështetje për grupin e punës të themeluar nga Ministria e punëve të brendshme, qëllimi i të cilit është që të hartojë *Doracakun e ri për regjistrim kriminalo-teknik dhe identifikim të personave dhe kufomave të panjohura*. Aido të përditësojë procedurat ekzistuese mbi regjistrimin kriminalo-teknik dhe identifikimin e bazuar në të dhënat biometrike

DCAF dhe R/QQS

DCAF - Qendra e Gjenevës për Qeverisje me Sektorin e Sigurisë angazhohet për rritje të cilësisë së sigurisë së vendeve dhe popujve në ato vende brenda qeverisjes demokratike, sundimit të ligjit, respektit ndaj të drejtave të njeriut, dhe barazisë gjinore. Që nga themelimi në vitin 2000, DCAF ka kontribuar duke rritur qëndrueshmërinë e paqes dhe zhvillimit përmes ndihmës ofruar shteteve partnere, dhe përmes mbështetjes që palët ndërkombëtare u ofrojnë këtyre shteteve për të rritur cilësinë e qeverisjes në sektorin e sigurisë me reforma gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje të të gjitha palëve. DCAF harton materiale njohurie që janë inovative, promovon normat dhe praktikatat e mira, ofron këshilla ligjore dhe të politikbërjes dhe mbështet ndërtimin e kapaciteteve të palëve që veprojnë në fushën e sigurisë- qofshin ato shtetërore apo jo. DCAF është një nga organizatat kryesore në botë në fushën e qeverisjes me sektorin e sigurisë (QSS) dhe reformat në sektorin e sigurisë (RSS).

Arritjet kryesore dhe kontributi i DCAF-it mund të shihen në [videon](#) më të re.

(ADN, daktiloskopi dhe fotografi) sipas kërkesave të reja nacionale dhe ndërkombëtare legjislativë. Roli i DCAF përfshin angazhimin e ekipit të ekspertëve nacional për të ofruar ndihmë dhe këshilla. Ishin organizuar tre takime të grupeve të punës për të diskutuar dhe shqyrtuar një koncept dhe skicë të Doracakut.





Punëtorja për shqyrtim që fokusohet në Ligjin mbi Agjencinë për sigurinë nacionale dhe Ligjin mbi koordinimin e bashkësisë të sigurisë dhe zbulimit,

15 prill 2022, Shkup

Programi për Reforma në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Prill 2021 - Mars 2026

Në vazhden e arritjeve të fundit, qëllimi i këtij Programi është të vijojë me procesin e reformave demokratike në sektorin e sigurisë në Maqedoninë e Veriut. Strategjia e intervenimit ka për qëllim të sigurojë që shërbimet e zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut funksionojnë siç duhet nën kontrollin dhe mbikëqyrjen aktive demokratike duke luftuar kundër krimeve serioze të organizuara dhe duke frenuar korrupsionin në përputhje me praktikën e mira të llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Ky Program është i strukturuar për të arritur tre rezultate:

Rezultati I: Ndryshim dhe plotësim i kornizave ligjore dhe institucionale në sektorin e zbulimit në Maqedoninë e Veriut në përputhje me parimet relevante Euro-Atlantike dhe praktikën e mira të llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Rezultati II: Organe të mbikëqyrjes së jashtme dhe kontrollit fitojnë njohuri dhe forcojnë kapacitetet për të zbatuar mbikëqyrje transparente dhe efektive të aktiviteteve që bën sektori i zbulimit.

Rezultati III: Opinioni informohet lidhur me funksionalitetin dhe rezultatet e sistemit të llogaridhënies së sigurisë dhe zbulimit.

Partnerët për zhvillim: Holanda (Ministria e Punëve të Jashtme), Suedia (Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim - Sida), Zvicra (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim -SDC) dhe Bashkimi Evropian.

Partnerët në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

- Kuvendi i Maqedonisë së Veriut
- Zyra e Kryeministrit
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Mbrojtjes
- Shërbimet e sigurisë dhe zbulimit
- Agjencia Teknike Operative (ATO)
- Agjencia për Mbrojtje të të Dhënave Personale
- Drejtoria për Siguri të Informatave të Klasifikuara
- Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë
- Zyra e Prokurorit Publik kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
- Gjykata dhe institucione të tjera gjyqësore
- Avokati i Popullit
- Revizioni i Shtetit
- OJQ-të dhe mediet

REZULTATI II

Në 15 prill të vitit 2022 në Shkup, DCAF ka organizuar një **Punëtori për rishikim që fokusohet në Ligjin mbi Agjencinë për siguri nacionale dhe Ligjin mbi koordinimin e komunitetit të sigurisë dhe zbulimit**. Qasja ishte konstruktive dhe e balancuar por gjithashtu kritike, nga perspektiva teorike dhe praktike e zbatimit. Kjo punëtori ka nxitur diskutim dhe pasqyrim mbi identifikimin e zgjidhjeve më përkatëse për të përmirësuar legjislacionin aktual në fushën e sigurisë - zbulimit. Kjo qasje ka kombinuar kontributin nga deputetët, shërbimi parlamentar, ekspertët lokal, dhe praktikuesit nga shërbimet e sigurisë-zbulimit, duke përfshirë edhe drejtorin e Agjencisë për siguri nacionale dhe drejtorin e Agjencisë teknike - operative. Ngjarja ishte pjesë e disa punëtorive për shqyrtim legjislativ të organizuara nga DCAF.



Punëtorja mbi konceptualizimin dhe përcaktimin e rregullores për përdorimin e Dhomës të mbrojtur në Parlament, 21 prill 2022, Shkup

Si pjesë e mbështetjes të DCAF për Kuvendin në ndërtimin dhe marrjen e akreditimit për një *Dhomë të mbrojtur dhe vend të mbrojtur të punës*, për trajtimin e informatave të klasifikuara, DCAF ka organizuar një **Punëtori shtesë për konceptualizimin dhe përcaktimin e rregullores për përdorimin e dhomës të mbrojtur**. Kjo punëtori është mbajtur **në 29 prill të vitit 2022** në Shkup dhe është pjesë e disa punëtorive në vitin 2022 që synojnë të sigurojnë se të gjithë përdoruesit janë të vetëdijshëm dhe kanë njohuri për aspektet fizike të sigurisë. I gjithë procesi është në pronësi lokale dhe udhëhiqet nga përfaqësuesit e Drejtorisë për sigurinë e informatave të klasifikuara dhe Ministrisë të punëve të brendshme që janë përgjegjës për sigurinë e Kuvendit.

Në përpjekjet e saj për të përforcuar mbikëqyrjen e sektorit të zbulimit dhe sigurisë, DCAF ka organizuar një **tryezë të rrumbullakët mbi mbikëqyrjen parlamentare të sigurisë dhe zbulimit** ndërmjet datave **19-22 qershor të vitit 2022** në Gjenevë të Zvicrës për deputetët dhe shërbimin parlamentar nga Maqedonia e Veriut. Synimi i kësaj tryeze të rrumbullakët ishte që të nënvizojë rëndësinë e rolit të parlamentit në procesin e demokratizimit të sektorit të sigurisë, të diskutojë sfidat kryesore që lidhen me mbikëqyrjen efektive parlamentare, dhe të mundësojë shkëmbimin e pikëpamjeve dhe praktikave të mira. Kjo ngjarje ka nënvizuar rolin thelbësor dhe të rëndësishëm kritik që kanë ligjvënësit në kuadër të sektorit të sigurisë. Tryeza ka gjeneruar diskutim

dhe dialog të shkëlqyer ndërmjet pjesëmarrësve mbi arritjet dhe sfidat kritike të mbikëqyrjes parlamentare të sigurisë dhe zbulimit në Maqedoninë e Veriut.

Në këtë periudhë, DCAF gjithashtu ishte fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve në kuadër të gjyqësorit. Në këtë drejtim, ne vazhduam që të realizojmë disa **punëtori me trajnime për trajnerë (TT) mbi përfshirjen dhe shpërndarjen (diseminimin)** për praktikuesit e gjyqësorit dhe ata ligjor me titull **Nga teoria në praktikë: Avancimi i praktikës gjyqësore mbi mbikëqyrjen e masave të posaçme hetimore duke përdorur metodat e mësimi dhe mbajtjes**. Ndërmjet datave **04-06 maj, 2022** në Berovë, DCAF ka mbajtur punëtorinë e katërt për TT, ndërsa ndërmjet datave **29 qershor - 01 korrik të vitit 2022** në Veles, është mbajtur punëtorja e 5-të dhe e fundit TT për trajnuesit e Akademisë për gjykatës dhe prokuror publik. Punëtorja e TT ka synuar që të ndërtojë kapacitetet dhe të lehtësojë sesionet e trajnimit në bazë të [Doracakut](#), të publikuar më herët në një mënyrë që është e qëndrueshme me parimet konceptuale të mësimi transformues dhe aktiv për të rritur. Realizimi i përfshirjes gjysëm ditore dhe punëtorive për shpërndarje ka vijuar në secilën prej pesë punëtorive duke u mundësuar pjesëmarrësve që të “vendosin në praktikë” mësimet nga punëtorja me një publik të drejtëpërdrejtë të praktikuesve gjyqësor nga e gjithë Maqedonia e Veriut.



Tryeza e rrumbullakët mbi mbikëqyrjen parlamentare të sigurisë dhe zbulimit,

19-22 qershor, 2022, Gjenevë, Zvicër



Punëtorja TT,

04-06 maj, 2022, Berovë

Në **8 qershor të vitit 2022**, DCAF ka organizuar një konferencë rajonale online për gjyqësorin me titull **Standardet dhe trendet e fundit në përdorimin e ndjekjes të komunikimeve në hetimet penale**. Kjo konferencë është organizuar nga DCAF dhe është realizuar nga **Programi për reforma në sektorin e zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut** dhe **Programi për drejtësi dhe siguri në Ballkanin Perëndimor**. Kjo ishte konferenca e pestë në rradhë në disa ngjarje rajonale online, të inicuar në mars të vitit 2021. Synimi i kësaj ngjarje rajonale është që të nxisë shkëmbimin e praktikave të mira dhe mësimet të nxjerra në fushën e autorizimit gjyqësor të masave të posaçme hetimore. Mbi 30 gjykatës, prokuror dhe ekspert ligjor nga rajoni

Mekanizmi i Partnerëve Zhvillimorë për Udhëheqje

Për këtë program u zgjodh mekanizmi i financimit të përbashkët dhe deri në dhjetor 2021 kanë kontribuar katër Partnerë Zhvillimorë. Këta janë Holanda (CHF 780'000), Suedia (rreth CHF 960'000), Zvicra (CHF 1'000'000), dhe Bashkimi Evropian (rreth CHF 320'000). Bashkë me kontributin vetanak të DCAF-it dhe mbështetjen me mjete jofinanciare nga partnerët përfitues, pra me sigurimin e zyrave, vendtakimeve, pajisjeve teknike, transportin lokal, dhe ekspertët, buxheti i përgjithshëm për periudhën 2021-2026 arrin CHF 4'939'219.

Ky Program udhëhiqet nga grupi i Komisioneve Udhëheqëse me partnerë të vendit përfitues dhe nga Grupi Udhëheqës i Partnerëve Zhvillimorë (GUPZH). GUPZH përbëhet nga Ambasadorët dhe ekipi i programit i nivelit të lartë. Ata angazhohen në mënyrë aktive me Programin duke ofruar këshilla politike dhe strategjike, këshilla për zbatim të rezeqeve dhe efektivitet në zbatim. Takimet e GUPZH mbahen një herë në tre muaj dhe organizohen nga misionet e Partnerëve Zhvillimorë me rotacion.



Punëtorja për përfshirje dhe shpërndarje,

29 qershor - 01 korrik, 2022, Veles

i Ballkanit Perëndimor kanë diskutuar praktikën gjyqësore që zhvillohet shpejtë nga Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut, që vendos standarde të larta në lidhje me detyrimin e gjykatësit për mbikëqyrje kritike, të gjithë aplikimet për përdorimin e metodave ndërhyrëse.

Në partneritet me Akademinë për gjykatës dhe prokuror publik, DCAF ka filluar me **organizimin e kurseve mbi parimet dhe standardet evropiane në procedurat gjyqësore për studentët e nivelit të parë**. Tre temat e para, të cilat u realizuan online, ishin si në vijim:



**Kursi për studentët e nivelit të parë mbi sfidat në
përdorimin e masave të posaçme hetimore,**

15 qershor 2022, Shkup

1. Standardet e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ) mbi masat e posaçme hetimore në kontekst të të drejtës për jetë private (Neni 8 i KEDNJ) - 9 maj,
2. Standardet e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut mbi masat e posaçme hetimore në kontekst të të drejtës për gjykim të drejtë (Neni 6 i KEDNJ) - 16 maj,
3. Përdorimi i masave të posaçme hetimore në kontekst të ekipeve të përbashkëta hetimore - udhëheqja e hetimeve efektive penale derisa vëzhgojnë nevojën për të respektuar të drejtën e privatësisë dhe gjykimin të drejtë - 3 qershor.

Në të gjithë kurset kanë marrë pjesë 60 gjykatës dhe prokuror aspirues, të gjithë të regjistruar në nivelin e parë të programit arsimor të Akademisë. Kursi i katërt ishte organizuar me prezencë fizike në **15 qershor të vitit 2022** në Shkup, dhe fokusohet në Sfidat për përdorimin e masave të posaçme hetimore. Në atë kurs kanë marrë pjesë 25 gjykatës dhe prokuror aspirues të regjistruar në nivelin hyrës të

programit arsimor të Akademisë. Dy kurset e ardhshme në këtë seri fokusohen në grumbullimin dhe ruajtjen e të dhënave në kontekstin digjital online dhe përdorimin e informatave të (kundër)zbulimit si dëshmi në gjykata. Që të dyja do të mbahen në shtator të vitit 2022.

Në **14 qershor të vitit 2022**, në Shkup, DCAF ka organizuar një **Tryezë të rumbullakët mbi integritetin policor** për 25 pjesëmarrës nga Departamenti për kontroll të brendshëm, hetime penale, dhe standarde profesionale. Në tryezën e rumbullakët ishte i pranishëm personeli i DCAF i cili ka lehtësuar një diskutim angazhues mbi menaxhimin e integritetit dhe prezantimin e praktikës ndërkombëtare mbi testimin e integritetit, si një prej disa mekanizmave të kontrollit të brendshëm. Tryeza e rumbullakët ishte hapi fillestar në ndërtimin e kapaciteteve të Departamentit në MPB, për zhvillimin e programit të tyre për testim të integritetit. DCAF do të vazhdojë të ofrojë mbështetje në kuadër të këtij procesi zhvillimor.



Diskusimi për tryezën e rumbullakët mbi integritetin e policisë,

13 qershor 2022, Shkup

REZULTATI III

Në 14 qershor të vitit 2022, në Shkup është mbajtur Takimi i tretë i Grupit të ekspertëve për pavarësi gjyqësore (EPGJ) mbi monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të masave të posaçme hetimore, me mbështetje të DCAF dhe nën udhëheqjen e Akademisë për gjykatës dhe prokuror publik. Misioni themelor i EPGJ është që të monitorojë dhe vlerësojë zhvillimin e praktikës lokale gjyqësore në autorizimin e MPH dhe harmonizimin e tyre me praktikën gjyqësore të GJEDNJ dhe praktikën e mirë evropiane. Ky forum i inicuar nga DCAF siguron vazhdimësi të një dialogu të strukturuar dhe shkëmbim ndërmjet praktikuesve të gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut, akademisë, dhe ekspertëve ndërkombëtar, duke kontribuar në qëndrueshmërinë e proceseve të mbikëqyrjes nacionale. Ekspertët ndërkombëtar dhe lokal kanë diskutuar mësimet e nxjerra në përdorimin e mbikëqyrjes të fshehtë në Austri dhe zhvillimet tjera në nivel evropian. Ishte analizuar hollësisht marrëdhënia ndërmjet gjyqësorit, parlamentit dhe organeve tjera të pavarura të mbikëqyrjes si dhe sistemit për mbikëqyrje të zbulimit dhe sigurisë të Maqedonisë së Veriut i cili është në një ngërç të shkaktuar nga ngecja në zbatimin e ligjit (Ligji mbi ndjekjen e komunikimeve, i miratuar në vitin 2018).

DCAF njeh rëndësinë e OSHC dhe sektorit të mediave, si zëra të rëndësishëm jo-shtetëror në kuadër të ciklit të llogaridhënies të zbulimit. Programi i DCAF bën



Trajnimi mbi Qeverisjen e sektorit të zbulimit dhe sigurisë dhe llogaridhënies: Roli i shoqërisë civile dhe mediave,
27-29 qershor 2022, Ohër

përpjekje për të inkurajuar përfshirjen e tyre aktive në proces duke mbështetur hulumtimin e pavarur, analizën dhe avokimin respektivisht përfaqësimin, por gjithashtu duke mbështetur rolin e tyre të rëndësishëm si lehtësues për një publik të informuar më mirë në çështjet e RSS.

Në këtë drejtim, ndërmjet **27-29 qershor 2022** në Ohër, DCAF ka organizuar një nga disa kurset e trajnimit të planifikuara për OSHC lokale dhe organizatat e mediave që synojnë të përforcojnë njohuritë e tyre, kapacitetet dhe të kuptuarit e mjedisit të sektorit të zbulimit dhe sigurisë dhe rolin e tyre në mbikëqyrjen informale të sektorit. Ngjarja me titull **Trajnimi mbi Qeverisjen e sektorit të zbulimit dhe sigurisë dhe llogaridhënien: Roli i shoqërisë civile dhe mediave** ka nënvizuar rëndësinë e aktorëve të pavarur, siç janë OSHC dhe mediat, në promovimin e qeverisjes më efektive të sektorit të zbulimit dhe sigurisë, përmes prezantimeve ndërvepruese, lojës në role dhe ushtrimeve praktike të lehtësuara nga një ekspert i jashtëm i RSS.

Në drejtim të ndërtimit të besimit publik dhe përforcimit të dukshmërisë të përparimit të reformave në sektorin e zbulimit dhe sigurisë, DCAF në bashkëpunim me kompaninë për produksione televizive 360 shkallë, ka prodhuar dy **storje shtesë audio-vizuale me dokumentarë të shkurtër**. Videot kombinojnë tregimin e storjeve dhe përmbajtjen informuese që synon të rrisë vetëdijen dhe të kuptuarin ndërmjet publikut më të gjërë. Videot ishin transmetuar në ALSAT TV në Maqedoninë e Veriut.



Takimi i tretë i Grupit të ekspertëve për pavarësi gjyqësore (EPGJ) mbi monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të masave të posaçme hetimore,

14 qershor 2022, Shkup



Fotografia e dokumentarit të shkurtër mbi zbrazëtitrat në Ligjin mbi ndjekjen e komunikimeve të transmetuara në Maj të vitit 2022

there are legal obstacles due to which the Civil Oversight Council can not function.

Storja me dokumentarin e shkurtër mbi **Zbrazëtitrat në Ligjin mbi ndjekjen e komunikimeve**, që ishte transmetuar në Maj të vitit 2022, ka theksuar rëndësinë dhe nevojën e ndryshimit të ligjit aktual i cili duhet të mundësojë punë më efektive dhe të strukturuar të institucioneve mbikëqyrëse duke përfshirë edhe Këshillin mbikëqyrje civile i cili nuk është funksional.

Ndërtimi i besimit në gjyqësor dhe ngritja e vetëdijes ndërmjet publikut të përgjithshëm ishin arsye kryesore për storjen e dytë të dokumentarit të shkurtër që gjithashtu ishte transmetuar në **maj të vitit 2022**. Videoja me titull **Agjentët e ndryshimit** ka ilustruar procesin e Trajnimit për trajnuesit (TT) e gjyqësorit. Ajo i ka prezantuar publikut ciklin e trajnimeve, përfshirjeve dhe punëtorive për shpërndarje të organizuara nga DCAF, përmes të cilave kanë marrë pjesë një grup i prokurorëve, gjykatësve, juristëve, profesorëve dhe të punësuarve në Ministrinë e punëve të brendshme. Synimi i këtyre ngjarjeve për trajnimet e TT ishte që



Fotografi nga dokumentari i shkurtër Agjentët e storjes të ndryshimit, të transmetuar në maj të vitit 2022

are learning how to most effectively train colleagues across the country in the application

të përforcohen kapacitetet e tyre për transferim më efektiv të njohurive të përfitura për kolegët në kuadër të gjyqësorit në çështjet siç janë përdorimi i masave të posaçme hetimore (MPH). Kjo video, gjithashtu është ndalur në specifikat e MPS dhe pse këto lloje të trajnimeve janë të nevojshme për sigurimin e përdorimit të harmonizuar dhe efektiv të MPH në përputhje me standardet ndërkombëtare.

AKTIVITET E ARDHSHE KORRIK 2022

- Diskutimet e grupeve nominale përmes ushtrimeve të përshtatura të bazuara në skenare në bashkëpunim me 'Iniciativën C3' të OSHC në Shkup
- Takimi i parë Eurotalk (sipas rregullave *Chatham House*) në bashkëpunim me OSHC 'EUROTHINK', në Shkup
- Punëtorja për GP të MPB për konceptualizimin e Doracakut për regjistrimin kriminalo-teknik dhe identifikimin e personave dhe kufomave të panjohura, në Berovë
- Fillimi i procesit të prokurimit të pajisjes të TI (*harduer dhe soft-uer*) për Departamentin e Forenzikës në Ministrinë e punëve të brendshme për themelimin e laboratorit të madhësisë të mesme për ADD për të realizuar CODIS. CODIS është shkurtesa për Sistemin e kombinuar të Indeksit të ADN dhe është nocioni gjenerik i përdorur për të përshkruar programin e FBI për mbështetje të bazës të drejtësisë penale të AND, si dhe softuerin e përdorur për të mbajtur këto baza të të dhënave

GUSHT 2022

- Prodhoni Video elektronike shpjeguese në formë të tutorialit mbi Procesin e lëshimit të certifikatave të sigurisë për personelin në bashkëpunim me Drejtorinë për sigurinë e informatave të klasifikuara (DSIK)
- Takimi përgatitës me ekspertët për zhvillimin e ushtrimeve praktike për punëtorinë mbi zbatimin e Standardeve të përbashkëta minimale për realizimin e vizitave të kontrollit dhe mbikëqyrjes në Institucionet e zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut
- Takim për finalizimin e konceptit të Doracakut për regjistrimin kriminalo-teknik dhe identifikimin e prsonave dhe kufomave të panjohura, Shkup

SHTATOR 2022

- Nënshkrimi i Memorandumit të mirëkuptimit me Qeverinë dhe Marrëveshjet për bashkëpunim me Ministrinë e mbrojtjes dhe Drejtorinë për sigurinë e informatave të klasifikuara (pritet të konfirmohet)
- Trajnimi i trajnuesve për realizimin e punëtorive mbi përmirësimin e qeverisjes të sektorit të zbulimit dhe sigurisë, në Veles
- Punëtorja për rregulloren për përdorimin e Dhomës të mbrojtur në Parlament, në Shkup
- Trajnimi mbi softuerin statistikor LRmix dhe EuroForMix për kalkulimin e peshës të dëshmimeve të ADN për ekspertët e ADN në kuadër të Departamentit të Forenzikës në Ministrinë e punëve të brendshme, në Shkup
- Takimi i grupit drejtës të punës me kryetarët e komisioneve parlamentare, DCAF dhe përfaqësuesit e Partnerëve tonë zhvillimor, në Shkup
- Takimi i dytë Eurotalk (sipas rregullave *Chatam House*) në bashkëpunim me OSHC 'EUROTHINK', në Shkup
- Fillimi zyrtar procesit të vetëvlerësimit gjinor në MM.